

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË “ GAIA CLINIC ” SHPK

Sot, më datë 04.07.2023 (dymijë e njëzet e tre), në praninë e Ortakëve Themelues të shoqërisë “**GAIA CLINIC**” SHPK tw paraqitur si më poshtë:

- **Z. Xhorxh Borshi**, i biri i Mehmet, i datëlindjes 04/08/1979, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal H90804156L, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

- **Z. Lorenc Goga**, i biri i Thoma, i datëlindjes 07/07/1985, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal I50707072T, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

- **Znj .Anisa Kurti**, e bija e Benon, e datëlindjes 13/07/1981 shtetase shqiptar, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, identifikuar me nr personal I26813136A, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Dhe

-**Znj.Ilda Tërshana**, e bija e Sakip, e datëlindjes 19/06/1982, shtetase shqiptar, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal I25619061W, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “**GAIA CLINIC**” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1
Emri i shoqërisë


- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “**GAIA CLINIC**” SHPK.
- 1.2. Ortakët Themelues të shoqërisë mbajnë përgjegjësi të kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë.

NENI 2
Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë “**GAIA CLINIC**” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3

1

The image shows three handwritten signatures in blue ink, each consisting of a stylized 'M' and a 'B'. They are positioned at the bottom of the page, corresponding to the 'NENI 3' section above them.

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga e Kavajes, Qendra Gurion, Nr 50, Kati 2, Tiranë,
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjeter brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4 Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.


NENI 5 Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, Hapja e klinikave dentare, laboratore dentare si dhe aktivitete të ndryshme në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë, Shit-blerje me shumicë dhe pakicë të pajisjeve dhe materialeve dentare dhe mjekësore, Import - Eksport të materialeve dhe pajisjeve dentare, si dhe çdo veprim tjeter i ligjshëm që ka të bëjë me fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë.

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë, e përbërë nga 4 (katër) kuota.
- 6.2. Ortakët themelues zoterojnë 4 (katër) kuota të kapitalit themeltar, të cilat i japin të drejtën e pjesëmarrjes sipas pwrqindjeve tw cituara mw poshtw.
- 6.3. Kapitali themeltar është nënshkruar në tërësinë e tij nga Ortakët Themelues, sipas kontributeve të shoqërisë kapitali i cili përbëhet si më poshtë:

1. Xhorxh Borshi zoteron 1 kuotë me 20 % të kapitalit themeltar me vlerë nominale 20,000 lekë
2. Z.Lorenc Goga horxh Borshi zoteron 1 kuotë me 20 % të kapitalit themeltar me vlerë nominale 20,000 lekë
3. Znj. Anisa Kurti zoteron 1 kuotë me 30 % të kapitalit themeltar me vlerë nominale 30,000 lekë



The image shows three handwritten signatures and initials in blue ink. On the left is a large, stylized signature. In the center is a smaller, more compact signature. To the right of the central signature is a large, sweeping initial 'G' and a smaller '2' below it. Further to the right is another set of initials and a signature.

4. Znj. Ilda Tërshana zotëron 1 kuotë me 30 % të kapitalit themeltar me vlerë nominale 30,000 lekë
- 6.4. Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 7 Organet Drejtuese

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**, organi më i lartë vendimmarrës;
- 2. Administratori** — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund te zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Administratori i Shoqërisë "GAIA CLINIC" SHPK do të jetë, është Znj. Anisa Kurti, e bija e Beton, e datëlindjes 13/07/1981 shtetase shqiptar, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, identifikuar me nr personal I26813136A, dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e cila emërohet për mandat me afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushton të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9 Ligji i aplikueshëm

9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10 Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.


3

NENI 11
Dispozitat përfundimtare


11.1 Ky Akt Themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues.

**ORTAKËT THEMELUES TË
SHOQËRISË “GAIA CLINIC” SHPK**
Përfaqësuar nga


Z. Xhorxh Borshi



Z. Lorenc Goga



Znj. Ilda Tërshana



Znj. Anisa Kurti

